



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-4262/25 datë:20.02.2025



Npi – 01/68 datë: 21.02.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 21.02.2025, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -II- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 21.02.2025 (e premte) në ora 15:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, dhe z.Arton Demiri. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtori: z.Besnik Ahmeti – DBF; Zyrtari për Komunitete dhe Kthim z.Muhamet Mehmeti si dhe znj.Vlora Hyseni, zyrtare për informim. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm prej 4 anëtarëve prezent, mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 24.01.2025,
2. Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, (Pas diskutimit publik)
3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për vlerësimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera FN&FT për Janar-Dhjetor 2024,
4. Propozim -Vendim për Subvencionimin e Nënave Lehona të Komunës së Shtimes për ç'do fëmijë të lindur,
5. Informatë e DBF-së për Raportin Periodik lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 24.01.2025

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 24.01.2025.**

Pika 2

Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt. (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, unë po propozoj që ti rekomandojmë Kuvendit miratimin e kësaj pike. Materialin për këtë pikë e keni marrë me kohë dhe e hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -II- për vitin 2025, të mbajtur më: 21.02.2025, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi Draft-Planin Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.**

Pika 3

Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për vlerësimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera FN&FT për Janar-Dhjetor 2024

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Materialin po besoj e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, prandaj unë nuk do të lëshohem në detaje por në pikat kryesore. Sa e di unë te vlerësimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera po bëhet fjalë për shumën totale rreth 93 mijë euro. Ne si Komunë vetëm e bëjmë vlerësimin e dëmit të shkaktuar ndërsa kompenzimin e bënë niveli qendror.

z. Besnik Seferi: Unë e di që Komisioni e ka bërë një listë të dëmeve që janë bërë gjatë vitit 2024, por nuk e di ku jemi me pagesat e këtyre dëmeve sepse nuk kemi diçka konkrete.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -II- për vitin 2025, të mbajtur më: 21.02.2025, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes të miratoi Raportin e Komisionit për vlerësimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në komunën e Shtimes për Janar-Dhjetor 2024. (FN&FT)**

Pika 4

Propozim -Vendim për Subvencionimin e Nënave Lehona të Komunës së Shtimes për ç'do fëmijë të lindur

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -II- për vitin 2025, të mbajtur më: 21.02.2025, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes të miratoi Vendimin për Subvencionimin e Nënave Lehona të Komunës së Shtimes për ç'do fëmijë të lindur.**

Pika 5

Informatë e DBF-së për Raportin Periodik lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Materialin për këtë pikë e keni marrë. Raprti i ka gjithsejt 8 rekomandime. Nga këto 3 rekomandime janë të reja ndërsa 5 prej tyre janë të vjetra. Detyrimet që dalin nga rekomandimi për Obligimet Kontigjente janë përmbushur në tërësi. Në vazhdim drejtori lexoi Informatën me rend sipas pikave 1 deri 8 (shih dokumentin). Ne nuk jemi pajtuar me rekomandimin, kemi dhënë sqarimet tona, mirëpo ne po përpiqemi që ti përmbushim të gjitha rekomandimet. Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përpiqem të jap sqarime.

z.Besnik Seferi: Për mua është pak shqetësuese që ka rekomandime të reja. Unë nuk kam diçka tjetër të shtoj përveç se po kërkoj që mos të kemi në të ardhmen rekomandime të reja nga Auditori i Përgjithshëm.

Pika 6
Të ndryshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Arton Demiri: Përshëndetje. Meqenëse jemi në prag të muajit të Ramazanit, unë u uroj të gjithë besimtarëve musliman agjërim të lehtë dhe sa më të mirë. Për këtë arsye unë po i propozoj Muhametit si përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim që ta përpilojë një listë të familjeve në nevojë për shpërndarjen e ndihmave me pako ushqimore për muajin Ramazan. Sa i përket komunitetit Rom ju bëj me dije se nuk keni nevojë sepse jam në dijeni për gjendjen e tyre, sepse nuk janë shumë familje.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; E përkrahu këtë propozim, por le ta bajnë listën në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale. Besoj që Muhameti e ka parsyshë këtë.

z.Muhamet Mehmeti, ZKKK: Përshëndetje. Sigurisht që do ta bëjmë këtë listë. Përpara e kemi bërë në bashkpunim me OJQ "Katari". E falënderoj drejtorin por edhe Besnikun. Ndërsa listën sigurisht që do ta bëjmë, me qëllim që këtë muaj të Ramazanit tu gjendemi afër për të ju ndihmuar sa do pak me gjërat ushqimore.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte mbledhjen e përfundoi në ora 16:05h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi